



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2018:035818

Datë: 13.11.2024

Numri i dokumentit: 06446571

P.nr. 75/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN - Dega Viti, Departamenti i përgjithshëm, sipas gjyqtares Blerina Jakupi Ramadani, me bashkëpunëtorin profesional Fitim Limani, duke vendosur në çështjen penale ndaj të pandehurit M.T. nga fshati K., Komuna e Vitisë për shkak të veprës penale: uzurpimi i pa ligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 paragrafi 2, nën paragrafi 2.1, lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i përgjithshëm me numër PP.II.nr.972/2014, e datës 05.05.2014, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, me datë 12.11.2024, në mungesë të palëve në të njëjtën datë, mori dhe shpalli publikisht, kurse me datë 13.11.2024, përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri **M.T.** nga babai D., nëna K., i lindur me datë 10.09.1972, në Viti, me vendbanim në fshatin K., Komuna Viti, me vendqëndrim në shtetin e Zvicrres, me adresë fal Kenëeg 8 8552 F. W, i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i punësuar në shtypshkronjë në Zvicërr, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i lëshuar nga MPB Prishtinë, Republika e Kosovës, me numër personal 1500154345 dhe shtetas i shtetit të Zvicrres, me numër identifikues FACHE003086859003.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse në kohë të pa vërtetuar mes vitit 2013 dhe 2014, në fshatin K., Komuna e Vitisë, i pandehuri në mënyrë të kundërligjshme ka uzurpuar pronën e paluajtshme-ngastren katastrale me numër 1457-0, në sipërfaqe prej 123m², e cila është pronësi shoqërore-komunale, e pa kategorizuar, me rrugë publike, të cilën i njëjti pa bazë juridike e shfrytëzon për vete ngase në të njëjtën ka të ndërtuar rrethojën e oborrit me material ndërtimor dhe dyert, ashtu që gjendja faktike është vërtetuar me datën 04.03.2014, nga Inspekcioni i Komunës së Vitisë, së bashku me ekspertin gjeodet.

-me këtë veprim ka kryer veprën penale uzurpimi i pa ligjshëm nga neni 332 paragrafi 2, nën paragrafi 2.1, lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4,7,17,38,40,42,44,69 dhe 70 të KPRK-së, si dhe nenit 322 paragrafi dhe 2 dhe nenit 364 parag. 1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, të pandehurit M.T., i shqipton:

Dënim me burgim,

i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit i zëvendësohet me dënim me gjobë

Të pandehurit M.T.për veprën penale sipas dispozitivit të këtij aktgjykimi i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh, ashtu që dënimi i shqiptuar do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi bëhet i plotfuqishëm.

Konform nenit 44 të KPK-së, me pëlqimin e të pandehurit, dënimi me burgim i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 1.200 (njëmijë e dyqind) €, të cilin dënim obligohet ta paguaj, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri i lartcekur nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, atëherë gjykata do t'ia zëvendëson dënimin me gjobë me dënim me burgim, ashtu që një ditë burgim do të barazohet me 20€ (njëzet euro) të dënimit me gjobë.

E dëmtuara Komuna e Vitisë, përfaqësuesi i saj, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i pandehuri që të paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 20€ (njëzet) dhe 20 (njëzet) euro për viktimat e krimit konform nenit 39 paragrafi 3 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave, në afat prej 15 ditësh pasi që ky aktgjykim të marrë formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 07.05.2014, në Gjykatën Themelore në Gjilan, dega në Viti, ka dorëzuar aktakuzën PP.II.nr.972/2014, të datës 05.05.2014, ndaj të pandehurit M.T.nga fshati K., Komuna e Vitisë për shkak të veprës penale uzurpimi i pa ligjshëm nga neni 332 paragrafi 2, nën paragrafi 2.1, lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Gjykata me datë 04.08.2016, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar dhe publik, në të cilën kanë qenë prezent prokurorja e shtetit Huma Jetishi dhe i pandehuri M.T.. Në këtë seancë, i pandehuri M.T.pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit kishte deklaruar se edhe pse e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, nuk e pranon fajësinë për kryerjen e saj, me ç'rast gjykata në kuptim të nenit 245 paragrafi 1, nën paragrafi 5 të KPPRK-së (kodi Nr. 04/L-123), e kishte njoftuar të pandehurin se mund të paraqes kundërshtimet për provat e cekura në aktakuzë si dhe kërkesën për hedhjen e aktakuzës.

Me datë 12.11.2024, gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor dhe publik, në të cilën kanë prezantuar prokurorja e shtetit K.F., përfaqësuesi i të dëmtuarës Komuna e Vitisë A.A., si dhe i pandehuri M.T.. Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, i pandehuri ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet.

2.Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata, pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 322 paragrafi 1, lidhur me paragrafin 2 të KPPRK-së, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë ndaj të pandehurit të lartcekur për veprën penale si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, pranimi i fajësisë nuk është rezultat i përdorimit të forcës, kërcënimeve apo premtimeve, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza edhe atë: vendimi i Drejtorisë së Inspektionit-Sektorit i Pronës, me numër 08, i datës 10.03.2014,

procesverbali mbi identifikimin dhe marrjen e të pandehurit në pyetje, i datës 20.03.2014, si dhe foto dokumentacioni mbi matjen manuale të uzurpimeve dhe shkresat e tjera në lëndë dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

Fjala përfundimtare e palëve

Prokurorja e shtetit K.F., në fjalën përfundimtare ka deklaruar: meqenëse i akuzuari e ka pranuar fajësinë në fazën e shqyrtimit gjyqësor, përkundër njoftimit nga ana e gjykatës për pasojat dhe benifitet e pranimit të fajësisë, ky pranim i fajësisë është i mbështetur në provat materiale të cilat i janë bashkangjitur aktit akuzues, fakte këto në bazë të të cilave argumentohet se tani i akuzuari ka kryer veprën penale siç është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës. Ka qëndruar pranë aktakuzës dhe propozimeve që e njëjta i përmban dhe ka kërkuar nga gjykata që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit.

Përfaqësuesi i të dëmtuarës Komuna e Vitisë, A.A., e ka përkrahur fjalën përfundimtare të prokurores se shtetit.

I pandehuri M.T. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se i vjen keq për uzurpimin e kësaj prone, mirëpo gjendja e kësaj prone ka theksuar se është trashëguar nga babai i tij që nga viti 1992, ndërsa lidhur me uzurpimin është njoftuar nga zyrtarët e Komunës së Vitisë në vitin 2014, duke theksuar se nëse i kërkohet nga zyrtarët e Komunës së Vitisë, të njëjtin do ta liroj. Nga gjykata ka kërkuar që ti shqiptohet një dënim sa më i butë, duke dhënë pëlqim që nëse gjykata i shqipton dënim me burg, të njëjtin të ja zëvendëson me dënim me gjobë dhe se kjo ka qenë hera e parë që ka kryer vepër penale.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri M.T. ka kryer veprën penale uzurpimi i pa ligjshëm nga neni 332 paragrafi 2, nën paragrafi 2.1, lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata, me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenin 322 paragrafi 1, lidhur me paragrafin 2 të KPPRK-së, ka vlerësuar se duhet të pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit dhe të njëjtit i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh, ashtu që dënimi i shqiptuar do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi bëhet i plotfuqishëm. Duke u bazuar në nenin 44 të KPRK-së dhe me pëlqimin e të pandehurit, gjykata ka vendosur që dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh, të njëjtit t'i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 1.200€ (njëmijë e dyqind) euro, të cilin dënim obligohet i pandehuri ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas ditës pasuese të plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës ky dënim do të jetë i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit dhe si i tillë me këtë dënim mund të arrihen qëllimet e dënimit në kuptim të nenit 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69 dhe 70 të KPRK-së, ashtu që si rrethana lehtësuese për të pandehurin gjykata mori pranimin e fajësisë, pendimin e tij për kryerjen e veprës penale, keqardhjen e shfaqur nga i pandehuri për këtë vepër penale, nga shkresat e lëndës shihet se për të pandehurin është hera e parë që ka kryer vepër penale, ka premtuar që do ta liroj pronën e uzurpuar, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata mori parasysh dashjen, shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit, faktin se uzurpimin e ka ushtruar në vazhdimësi edhe pse me vendimin e datës 10.03.2021 është urdhëruar i pandehuri që ta liroj pronën e uzurpuar shtetërore. Andaj edhe mbi të lartcekurat gjykata konsideron se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit të lartcekur duke i marrë parasysh rrethanat

e përmendura si më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së tij.

5. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit duke i marr parasysh rrethanat e lartpërmendura është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, me mënyrën e kryerjes së veprës penale si dhe shkallën e përgjegjësisë së tij. Gjykata, po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së.

6. Vendimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike

Gjykata në bazë të nenit 462 paragrafi 2 të KPP-së, të dëmtuarën Komuna e Vitisë, përfaqësuesin ligjor të saj, për realizimin e kërkesës pasurore juridike e ka udhëzuar në kontest të rregullt juridiko civil.

7. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurit, gjykata, duke u bazuar në nenin 449 të KPP-së, ka vendosur që të pandehurin ta obligojë ti paguajë shpenzimet procedurale sipas përlogaritjes përfundimtare nga ana e gjykatës, paushallin gjyqësor në shumë prej 20€ dhe shumë prej 20€, për kompensimin e viktimave të krimit, në afat prej 15 ditëve pas ditës pasuese të plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata konform nenit 364 paragrafi 1 të KPRK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Gjykata Themelore në Gjilan, dega Viti
Departamenti i përgjithshëm
P.nr. 75/2020, me datë 13.11.2024**

**Gjyqtarja e vetme gjykuese,
Blerina Jakupi Ramadani**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj Gjykate Themelore.